



STRATEGJIA NË UDHËKRYQ

(RAPORT I MONITORIMIT TË ZBATIMIT TË
STRATEGJISË PËR SUNDIMIN E LIGJIT
DHE PLANIT TË VEPRIMIT)



Autorë: Gzim Shala, Astrit Kolaj, Naim Jakaj dhe Melos Kolshi.

Ekipi redaktues: Ehat Miftaraj dhe Betim Musliu.

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e National Endowment for Democracy (NED).

Implementuar nga:



Mbështetur nga:



RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD, Rr. Ilaz Agushi
Prishtinë
E: info@kli-ks.org
www.kli-ks.org

Qershor, 2024
Prishtinë, Republika e Kosovës

PËRMBAJTJA

09	1. Përmbledhje ekzekutive
10	2. Zbatimi i Strategjisë në numra
11	3. Paralizimi i SSL-it
12	4. Mungesa e buxhetit
13	5. Diskutimi kundërkushtetues i Kuvendit për drejtësinë
14	6. Fryrja e numrit të aktiviteteve
15	7. Pasaktësia në raportim
19	8. Stagnimi në “proces”
20	9. Mungesa e barazisë gjinore në KPK
23	10. Mos zbatimi i aktiviteteve lehtë të zbatueshme
24	11. Koncept Dokumenti për Persona që u është kufizuar liria e lëvizjes nga Gjykata

SHKURTESAT

IKD	Instituti i Kosovës për Drejtësi
RFSSL	Rishikimi Funkcional i Sektorit të Sundimit të Ligjit
SSL	Strategjia për Sundimin e Ligjit
MD	Ministria e Drejtësisë
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
ANJF	Agjencia për Ndihmë Juridike Falas
ShKK	Shërbimi Korrektues i Kosovës
ShSK	Shërbimi Sprovues i Kosovës
ANjF	Agjencia për Ndihmë Juridike Falas
AD	Akademia e Drejtësisë
APK	Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit
OAK	Oda e Avokatëve të Kosovës
AIP	Agjencia për Informim dhe Privatësi
PK	Policia e Kosovës
KPPRK	Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës

1. Përmbledhje ekzekutive

Qeveria e Republikës së Kosovës më 11 gusht 2021 miratoi Strategjinë për Sundimin e Ligjit (SSL) për vitet 2021-2026. Kjo Strategji është derivat i procesit të Rishikimit Funkcional të Sistemit të Sundimit të Ligjit (RFSSL), i cili proces paraqet një prej iniciativave më të mëdha dhe më serioze për avancimin e sundimit të ligjit në Kosovë. Megjithatë, miratimi i kësaj Strategjie nuk është përcjellë me vullnet të mjaftueshëm për zbatimin e saj në praktikë. Në raportin e kaluar, IKD gjente se raportimi lidhur me nivelin e zbatimit të Strategjisë nuk ishte real dhe kjo për dy arsye: Mos zbatimi i aktiviteteve në përputhje me SSL-në dhe dokumentet e dala nga RFSSL dhe raportimi i pasaktë mbi zbatimin e aktiviteteve të parapara me Planin e Veprimit (PV). Problemet lidhur me zbatimin e SSL-së kanë vazhduar.

Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2023 theksoi se SSL dhe PV vazhdojnë të implementohen me ritëm të ngadaltë. Regres konstatohet edhe në vet raportin e Komitetit Drejtues mbi zbatimin e SSL-së dhe PV-së. Mungesën e buxhetit të mjaftueshëm ky raport e konstaton si sfidë. Evidentimi i kësaj sfide qartazi shpërfaq mungesë të vullnetit të Qeverisë për zbatimin e kësaj Strategjie. Qeveria që miratoi SSL-në dhe PV-në është po ashtu përgjegjëse për përgatitjen e buxhetit dhe ka shumicën parlamentare për miratimin e buxhetit. Kështu, miratimi i SSL-së dhe PV-së, i pa shoqëruar me buxhet adekuat, shpërfaq mungesë të vullnetit real për zbatimin e SSL-së në praktikë.

Në anën tjetër, IKD ka gjetur se në PV në disa nga masat e politikave janë vendosur disa aktivitete, që në thelb janë i njëjti aktivitet. Në anën tjetër, IKD ka identifikuar një sërë raste të pasaktësisë në raportimin lidhur me zbatimin e SSL-së. Këto situata krijojnë një tablo jo reale të nivelit të zbatimit të SSL-së në praktikë.

Tutje, IKD ka evidentuar gjithsej 38 aktivitete të vitit 2022, të cilat sipas Raportit vjetor për zbatimin e SSL-së për vitin 2023, është dashur të përfundojnë në vitin 2022. Por, këto aktivitete, nuk janë përbushur fare, madje as nuk kanë filluar të përbushen, as në vitin 2023. Po ashtu, IKD ka evidentuar gjithsej 71 aktivitete të vitin 2022, të cilat në Raportin vjetor për zbatimin e Strategjisë për Sundimin e Ligjit 2023, janë evidentuar si pjesërisht të zbatuara, por që zbatimi i tyre nuk ka përfunduar as në vitin 2023. Për më tepër, IKD ka gjetur një numër të konsiderueshëm të aktiviteteve të pazbatuara plotësisht, zbatimi i të cilave nuk has në pengesa të konsiderueshme.

Përtej këtyre, SSL tanimë është jashtë zbatimit. SSL zbatohet përmes Planit të saj të Veprimit, i cili plan ka skaduar në fund të vitit 2023. Vet SSL-ja ka përcaktuar se rishikimi afatmesëm i Planit të Veprimit do të bëhet "...jo më larg se deri në fillim të vitit 2024...". Në çfarëdo interpretimi, më së largu, fillimi i vitit mund të konsiderohet fundi i muajit mars të vitit përkatës, përkatësisht përfundimi i tremujorit të parë. Në këtë logjikë, procesi i rishikimit afatmesëm të Strategjisë është dashur të përfundohet deri më 31 mars 2024. Ky obligim i Strategjisë nuk është përbushur. Si rrjedhojë, SSL ka mbetur ka Plan të Veprimit. Dështimi për të bërë vlerësimin afatmesëm të SSL-së dhe dështimi për të miratuar Planin e ri të Veprimit, e ka paralizuar SSL-në, duke e lënë si një dokument në fuqi, në të cilin nuk ka se çfarë të implementohet.

2. Zbatimi i Strategjisë në numra

Më 13 maj 2024, Komiteti Drejtues (KD) i Strategjisë për Sundimin e Ligjit (SSL) prezantoi Raportin vjetor të zbatimit të SSL-së për vitin 2023. Ky raport dëshmon regres të zbatimit të SSL-së në raport me vitin paraprak. Raporti tregon se 41% e Planit të Veprimit (PV) i SSL për vitin 2023 është zbatuar plotësisht apo 2% më pak se në vitin paraprak. Sipas raportit, 34% e aktiviteteve të planifikuara janë zbatuar pjesësisht, pra 11% më pak se në vitin paraprak. Mos zbatueshmëria pati ngritje për 12%, ashtu që përqindja e aktiviteteve të pazbatuara sipas Planit të Veprimit të SSL arriti në 24%.

	2022	2023
Të zbatuara	43%	41%
Të pazbatuara	12%	24%
Pjesërisht	45%	34%

Treguesi nr. 1, Përqindja e akviteteve, krahasimi ndërmjet vitit 2022 dhe 2023

Në tërësinë e tij, raporti i KD-së të SSL-së tregon se PV i SSL 2021-2023, është zbatuar plotësisht 55%, pjesërisht 26% dhe 19% aktivitetet nuk janë zbatuar fare.

Të zbatuara	55%
Të pazbatuara	19%
Pjesërisht	26%

Treguesi nr. 1, Përqindja e akviteteve, 2022 dhe 2023

Duke abstrahuar problemet lidhur me raportimin e zbatueshmërisë së SSL-së në raportin e kaluar të publikuar nga IKD[1] dhe në këtë raport, përmbyllja e periudhës që mbulon Plani i Veprimit me 45% të aktiviteteve të pazbatuara (19% të pazbatuara dhe 26% pjesërisht të zbatuara) është nivel shqetësues i moszbatimit. Kjo veçanërisht kur kemi parasysh rëndësinë që ka SSL në avancimin e sundimit të Ligjit në Kosovë.

[1] Zekaj E., Makshana L., Shala G., Jakaj N., "(Mos) Zbatimi i Strategjisë së Sundimit të Ligjit në Praktikë", Instituti i Kosovës për Drejtësi, Prishtinë, Tetor 2023. (Shih linkun: <https://kli-ks.org/ep-content/uploads/2023/10/Mos-Zbatimi-i-Strategjise-se-Sundimit-te-Ligjit-ne-Praktike-1.pdf>). (Qasur për herë të fundit më 10 qershor 2024)

Raporti nuk tregon në hollësi se pse 19% e aktiviteteve nuk janë zbatuar ose pse 26% janë zbatuar vetëm pjesërisht. Hartuesi i këtij raporti është dashur që t'i identifikojë shkaqet e mos realizimit të secilit aktivitet. Në pjesën e parë të raportit përmenden arsyet buxhetore, bashkëpunimi ndër institucional dhe mungesa e stafit si arsye për mos zbatimin e SSL-së, por këto çështje janë përmendur vetëm si sfida të përgjithshme dhe nuk është dhënë analizë specifike për secilin aktivitet që nuk ka arritur të zbatohet. Kështu, për aktivitete specifike, nuk janë dhënë arsye se pse nuk janë përmbushur. Fatkeqësisht, nga kjo mungesë e informacioni në këtë raport rrezikon që të preket edhe cilësia e rishikimit të PV dhe Planit të ri të Veprimit.

3. Paralizimi i SSL-it

Pas zhvillimit të procesit të Rishikimit Funkcional të Sektorit të Sundimit të Ligjit, Qeveria e Republikës së Kosovës më 11 gusht 2021 miratoi Strategjinë për Sundimin e Ligjit për vitet 2021-2026. Pjesë e kësaj strategjie ishte edhe Plani i saj i Veprimit për vitet 2021-2023. Plani i Veprimit përmbante aktivitete specifike, elaboronte në hollësi objektivat strategjike dhe specifike, veprimet, institucionet përgjegjëse, koston financiare për zbatim si dhe treguesit[2]. Por, në fund të vitit 2023, ky plan tanimë ka skaduar.

Vet Strategjia për Sundimin e Ligjit ka përcaktuar se "strategjia parashihet t'i nënshtrohet rishikimit afatmesëm, jo më larg se deri në fillim të vitit 2024 për të vlerësuar efektivitetin dhe efikasitetin e zbatimit të saj...". Në Raportin Vjetor për Zbatimin e SSL-së për vitin 2023 theksohet se "Rishikimi afatmesëm i Strategjisë parashihet të bëhet në vitin 2024, ndërsa këtij rishikimi dhe hartimit të Planit të ri të Veprimit të Strategjisë 2024-2026 i parashihet t'i paraprijnë analiza specifike të sektorit, e cilat parashihet të hartohen me mbështetje të partnerëve zhvillimorë të Kosovës"[3]

Fillimisht, duhet theksuar se vet SSL ka përcaktuar se rishikimi afatmesëm i Planit të Veprimit do të bëhet "...jo më larg se deri në fillim të vitit 2024...". Në çfarëdo interpretimi, më së largu, fillimi i vitit mund të konsiderohet fundi i muajit mars të vitit përkatës, përkatësisht përfundimi i tremujorit të parë. Në këtë logjikë, procesi i rishikimit afatmesëm të Strategjisë është dashur të përfundohej deri më 31 mars 2024.

Ky obligim i Strategjisë nuk është përmbushur. Si rrjedhojë, SSL ka mbetur pa Plan të Veprimit. SSL, në mënyrë se si është ndërtuar, nuk është vetvetiu e zbatueshme, pa një Plan të Veprimit i cili liston specifikisht aktivitetet që duhet t'i kryejnë institucionet, me qëllim të zbatimit të objektivave të përcaktuara nga SSL. Kështu, dështimi për të bërë vlerësimin afatmesëm të SSL-së dhe dështimi për të miratuar Planin e ri të Veprimit e ka paralizuar SSL-në, duke e lënë si një dokument në fuqi, në të cilin nuk ka se çfarë të implementohet.

[2] "Strategjia për Sundimin e Ligjit 2021-2026", fq. 41, Ministria e Drejtësisë, Gusht 2021. (Shih linkun: <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/6DC1CBD5-0DF1-46AE-9D1A-78C96146C7D0.pdf>). (Qasur për herë të fundit 10 qershor 2024).

[3] "Raporti një vjeçar (2023) për zbatimin e Planit të Veprimit për zbatimin e SSL-it", fq.2., Ministria e Drejtësisë. (Shih linkun: <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/7C77BBBD-C7BD-44D6-A5FC-AB21ADE19481.pdf>). (Qasur për herë të fundit 10 qershor 2024).

Në anën tjetër, ka edhe diskrepancë në mes të asaj që thuhet në SSL dhe në Raportin për zbatimin e SSL për vitin 2023. Përderisa SSL thotë se rishikimi afatmesëm do të kryhet në fillim të vitit 2024, Raporti Vjetor i Zbatimit nuk përmend “fillimin”, por vetëm vitin 2024.

Por, në bazë të deklarimeve të Ministres së Drejtësisë, duket se Plan të Veprimit nuk do të ketë fare gjatë vitit 2024. Në takimin e Komitetit Drejtues, Haxhiu deklaroi se “nuk do të ndalemi pavarësisht pengesave që po i hasim, dhe se duhet shikuar drejt Planit të ri të Veprimit të Strategjisë 2025–2026 dhe zotimeve tjera, ashtu që përkushtimi dhe vullneti që e kemi, të sigurojë që reforma është e plotë”. Kështu, kjo situatë do të bënte që paralizimi i SSL të zgjaste për tërë vitin. E gjithë kjo në kundërshtim me atë çfarë është përcaktuar në SSL.

4. Mungesa e buxhetit

Raporti Vjetor (2023) i Zbatimit të SSL-së, tregon fillimisht se nga kostoja e planifikuar e aktiviteteve për vitin 2023, vetëm 32% e buxhetit është shpenzuar që korrespondon me aktivitetet e zbatuara. Më tutje, raporti tregon se aktivitetet më së shumti të kushtueshme ende nuk janë zbatuar. Në anën tjetër, raporti ka identifikuar mungesën e buxhetit dhe të kapaciteteve si rreziqet për mos zbatimin e plotë të aktiviteteve në kuadër të PV të SSL-it. Por, raporti nuk tregon se në cilat aktivitete ka munguar buxheti dhe kush është përgjegjësi institucional për mungesën e mjeteve. Për më tepër, njëri ndër rekomandimet që ka bërë Komiteti Drejtues ka qenë se për zbatimin e aktiviteteve të caktuara ka nevojë që buxheti të sigurohet dhe se hapi që duhet adresuar është Ministria e Financave dhe Kuvendi i Kosovës të marrin parasysh kërkesat buxhetore të institucioneve për zbatimin e aktiviteteve që kanë ngecur deri tash në Strategji.

Strategjia e sundimit të ligjit në Kosovë është ndërtuar mbi parimet e një kornize të integruar planifikimi që synon të sigurojë një qasje koherente, efikase dhe të integruar. Ashtu siç është shkruar në të, strategjia parashikon një sinkronizim të plotë me dokumentet qeveritare të planifikimit të politikave dhe atyre buxhetore.[4] Kjo nënkupton që secili aspekt i strategjisë duhet të ketë një mbështetje të qartë financiare të parashikuar në dokumentet përkatëse buxhetore. Një gjë e tillë, siç shihet me Raportin Vjetor të zbatimit të SSL-it, nuk është bërë. Strategjia thotë se ka një planifikim buxhetor të parashikuar, por që raportet e zbatimit vlerësojnë mungesë të tij.

Pa mbështetje financiare, strategjitë do të mbeten të porealizuara, duke dëmtuar efektivitetin e sundimit të ligjit në vend. Avancimi i sundimit të Ligjit nuk mund të bëhet përmes miratimit të dokumenteve të cilat përcaktojnë obligime për institucionet përkatëse, por nuk ndahet buxhet adekuat për realizimin e atyre obligimeve. Përderisa Strategjia është miratuar nga vet Qeveria e cila drafton edhe buxhetin i cili miratohet nga Kuvendi, është paradoksale kur në dokumentet e Komitetit Drejtues, ku merr pjesë edhe MD, shprehen ankesat për mungesë të buxhetit.

[4] “Strategjia për Sundimin e Ligjit 2021–2026”, Ministria e Drejtësisë, Gusht 2021. (Shih linkun: <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/6DC1CBD5-0DF1-46AE-9D1A-78C96146C7D0.pdf>). (Qasur për herë të fundit 10 qershor 2024).

Kështu, për të siguruar një sistem të drejtë dhe efikas të drejtësisë, qeveria duhet të sigurojë financimin e duhur për të mbështetur institucionet dhe për të garantuar zbatimin e plotë të strategjisë. Institucionet publike nuk mund të mbahen përgjegjëse në mënyrë adekuate, nëse për realizimin e aktiviteteve të tyre nuk kanë pasur buxhet të mjaftueshëm.

KONKLUZION

Raporti Vjetor (2023) i Zbatimit të SSL-së thekson se vetëm 32% e buxhetit të planifikuar për 2023 është shpenzuar, dhe aktivitetet më të kushtueshme nuk janë zbatuar. Mungesa e buxhetit dhe kapaciteteve janë identifikuar si reziqe kryesore, pa specifikuar përgjegjësinë institucionale për këtë. Komiteti Drejtues rekomandon që Ministria e Financave dhe Kuvendi të marrin parasysh kërkesat buxhetore për aktivitetet e nevojshme. Strategjia kërkon planifikim dhe financim të qartë, gjë që nuk është realizuar, duke penguar efektivitetin e sundimit të ligjit në vend. Miratimi i Strategjisë për Sundim të Ligjit, pa shoqërim të së njëjtës me mjete adekuate buxhetore, nuk paraqet përkushtim të mjaftueshëm për avancimin e sundimit të ligjit.

5. Diskutimi kundërkushtetues i Kuvendit për drejtësinë

Sipas Kushtetutës së Kosovës, Neni 108. Par. 8, "Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës i drejtohet Kuvendit të Republikës së Kosovës së paku një herë në vit lidhur me Sistemin Gjyqësor". Në rastin e KPK, Ligji përcakton se Kryesuesi i KPK-së, "paraqet raport me shkrim së paku një (1) herë në vit para Kuvendit mbi performancën, veprimet, shpenzimet dhe nevojat e Prokurorit të Shtetit".[5]

Diskutimi i rregullt i raporteve vjetore nga KGJK dhe KPK në Kuvendin e Kosovës, ishte njëri prej aktiviteteve në PV-së të SSL-së. Ky aktivitet nuk u zbatua.

Moszbatimi i këtij aktiviteti nuk paraqet problem. Problem është planifikimi i këtij aktiviteti kundër kushtetues. Në asnjë rrethanë, nuk mund të vendosen aktivitete që për qëllim kanë të diskutojnë mbi raportet e institucioneve të pavarura kushtetuese si KGJK dhe KPK. Diskutimi mbi këto raporte në Kuvend është interferim i një pushteti në punën e pushtetit tjetër. Çfarëdo diskutimi i bërë, nuk mund të pasojë me asnjë veprim, andaj përpos se ndërhyrje edhe është i pa objekt.

Sa i përket nenit 108.8 të Kushtetutës, ky nen përcakton se Kryesuesi i KGJK-së i drejtohet Kuvendit një herë në vit, ngjashëm sikurse Presidenti i vendit.[6] Kështu, sipas Kushtetutës, kryesuesi i KGJK ka për detyrim të paraqes informacionin e duhur për gjyqësorin para Kuvendit. Ky obligim nuk tërheq pas vetëm obligimin për raportim të veçantë para Kuvendit. Në rastin e KPK-së, Ligji përcakton vetëm obligimin e njoftimit të Kuvendit me shkrim, por jo raportimin e veçantë.

[5] "Neni 11, nënparagrafi 2.6, Ligji Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës", 7 mars 2019, Gazeta Zyrtare e Kosovës. (Shih linkun: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18920>). (Qasur për herë të fundit 10 qershor 2024).

[6] "Neni 84, paragrafi 3, Kushtetuta e Kosovës", Prill 2008, Gazeta Zyrtare e Kosovës. (<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>). (Qasur për herë të fundit 10 qershor 2024).

Për këto arsye, IKD i rekomandon Qeverisë që në Planin e ri të Veprimit të hiqet ky aktivitet dhe të vendoset aktiviteti adekuat, e që është, "Kryesuesi i KGJK i drejtohet së paku një herë në vit Kuvendit të Kosovës ndërsa KPK e njofton Kuvendin me shkrim".

KONKLUZION

Aktivitetet që kanë për synim dhe qëllim diskutimin e raporteve të institucioneve të sistemit të drejtësisë në Kuvendin e Kosovës, janë në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës, ligjet në fuqi dhe me standardet ndërkombëtare. Kuvendi nuk e ka autoritetin për të mbajtur përgjegjës institucionet e sistemit të drejtësisë. Ky aktivitet dhe aktivitete të tjera të kësaj natyre duhet të shmangen në Planin e ri të Veprimit.

6. Fryrja e numrit të aktiviteteve

Në Planin e Veprimit për Zbatimin e SSL-së, në disa nga masat e politikave, të cilat shihen edhe në Raportin Vjetor (2023), janë vendosur disa aktivitete, që në thelb janë i njëjti aktivitet. Kjo mënyrë e veprimit krijon një situatë jo reale me rastin e raportimit të zbatimit të SSL.

Në Kapitullin 2.4 – "Garantimi i integritetit të Policisë së Kosovës, Masa e politikës: Infrastrukturë dhe administratë që fuqizon zyrtarët policor 30% zbatuar plotësisht", aktivitetet 1 dhe 6 dhe Masa e politikës: Veting i përmirësuar dhe përputhshmëri me kodin e etikës, aktivitetet nr. 11, 15 dhe 16 në esencë janë aktiviteti i njëjti. Të gjitha këto aktivitete, janë aktiviteti i njëjte: Plotësimi dhe ndryshimi i Ligjit për Policinë, i cili duhet të bëhet në përputhje me SSL-në dhe dokumentet e politikave të RFSSL. Kështu, këto pesë aktivitete të planifikuara, në esencë janë nga një aktivitet në dy masa. Megjithatë, në rastin konkret, IKD gjënë se ky Projektligji u planifikua të miratohej fillimisht në mes të vitit 2022[7], e më pas në fund të vitit 2022[8]. Përkundër kësaj, Qeveria nuk arriti të miratojë këtë Projektligj gjatë vitit 2022. Ky dështim u vazhdua. Qeveria hoqi dorë nga miratimi i këtij Projektligji, duke mos e përfshirë të njëjtin as në programin legjislativ për vitin 2023[9], e as në atë për vitin 2024.[10] Kështu, kjo situatë paraqet edhe një problem tjetër: Mos harmonizimin e PV-së të SSL-së me PL-në e Qeverisë. PV-ja e SSL-së supozohet të jetë një dokument strategjik tre vjeçar, mbi bazën e të cilit planifikohen dhe zbatohen edhe veprimet e tjera. Mos harmonizimi i dokumenteve të veçanta, siç është PL-ja e Qeverisë me PV-në e SSL-së paraqet një injorim të PV-së të SSL-së, duke ia humbur karakterin e planifikimit strategjik që mbart i njëjti.

[7] "Programi Legjislativ për vitin" 2022, Qershor 2022, Zyra e Kryeministrit. (Shih linkun: <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/05/Programi-Legjislativ-per-vitin-2022.pdf>). (Qasur për herë të fundit 10 qershor 2024).

[8] "Programi Legjislativ për vitin 2022", Dhjetor 2022, Zyra e Kryeministrit. (Shih linkun: <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/10/Programi-Legjislativ-per-vitin-2022.-27.10.2022...pdf>). (Qasur për herë të fundit 10 qershor 2024).

[9] "Programi Legjislativ për vitin 2023", Janar 2023, Zyra e Kryeministrit. (Shih linkun: <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/11/Programi-Legjislativ-per-vitin-2023-9.11.2023.pdf>). (Qasur për herë të fundit 10 qershor 2024).

[10] "Programi Legjislativ për vitin 2024", Janar 2024, Zyra e Kryeministrit. (Shih linkun: <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2024/02/Programi-Legjislativ-per-vitin-2024-.pdf>). (Qasur për herë të fundit 10 qershor 2024).

Në anën tjetër, fryrje e numrit të aktiviteteve evidentohet edhe tek aktivitetet 27, fq. 55, aktiviteti 32, fq. 56, aktiviteti 4, fq. 72, dhe aktiviteti 4, 5 dhe 7, fq. 41, që kanë të bëjnë me Projektligjin për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit për KPK-në dhe Projektkodin Penal të Republikës së Kosovës.

KONKLUZION

PV i SSL-së 2021-2023 paraqet fryrje të numrit të aktiviteteve, duke ndarë dhe paraqitur disa aktivitete që në thelb janë një aktivitet. Kjo situatë paraqet një gjendje jo reale me rastin e raportimit të zbatimit të SSL-së. Andaj, në Planin e ri të Veprimit duhet të shmangët kjo fryrje e numrit, duke u specifikuar secili aktivitet, i cili duhet të përmbushet në përputhje me SSL-në dhe dokumentet e politikave të RFSSL-së.

7. Pasaktësia në raportim

Në Raportin e titulluar “(Mos) Zbatimi i Strategjisë së Sundimit të Ligjit në Praktikë” IKD kishte evidentuar pasaktësi në raportimin lidhur me përmbushjen e PV-së të SSL-së. Pasaktësi të kësaj natyre janë evidentuar edhe në Raportin e zbatimit të PV-së të SSL-së për vitin 2023.

Kështu, IKD ka gjetur se aktiviteti “KPK ndërmerr fushatat të vazhdueshme mediale dhe informative për të rritur ndërgjegjësimin e publikut për sistemin e ri ligjor të përgjegjësisë disiplinore të prokurorëve” është konstatuar si i përmbushur. Në ndërkohë për këtë aktivitet vet raporti konstaton se “nuk ka pasur kampanja gjate periudhës raportuese”. Në anën tjetër, në raportin për zbatimin e aktiviteteve të PV-së të SSL-së për vitin 2022, thuhet se KPK ka përgatitur kampanjë vetëdijesuese përmes një video-spoti lidhur me punën e sistemit prokurorial, por që nuk është vendosur burimi dhe nuk tregohet se ku është lancuar kjo kampanjë.

Aktiviteti tjetër që karakterizohet me probleme në raportimin e zbatimit të tij është “Themelimi i një grupi punues të vetëm për rishikimin e legjislacionit në fushën komerciale”. Produkti i paraparë për këtë aktivitet është “Komisioni i themeluar dhe funksional”. Tek komentet mbi realizimin e aktiviteteve thuhet se aktiviteti është në zhvillim e sipër, pasi “është miratuar në Qeveri Projektligji për Falimentimin, kjo çështje është trajtuar edhe në procesin e hartimit të koncept dokumenteve përkatëse: Koncept Dokumenti për Gjykatën Administrative dhe të Punës dhe Koncept Dokumenti për Kodin e Procedurës Civile”.

Nëse analizojmë këto të dhëna, atëherë shohim se raportimi i këtij aktiviteti si pjesërisht i zbatuar nuk është i saktë. Fillimisht, produkti që kërkohet është thjesht themelimi dhe funksionalizimi i Komisionit në fjalë, që supozohet ta rishikojë tërë legjislacionin në këtë fushë. Ekskluzivisht, ky aktivitet synon krijimin e një grupi punues që rishikon tërësinë e legjislacionit në fushën komerciale. Iniciativa të tjera të cilat në mënyrë indirekte ka mundësi të kenë trajtuar këtë çështje nuk mund të merren si relevante për këtë aktivitet.

Në anën tjetër, IKD gjatë monitorimit të zbatimit të SSL-së ka gjetur edhe aktivitete të cilat janë realizuar por që janë raportuar si të pazbatuara. I tillë është rasti me rregulloren "Hartimi i një Rregulloreje të re për rekrutimin, provimin, emërimin, riemërimin dhe transferin e gjyqtarëve". Përkundër faktit se KGJK ka treguar se produkti i pritur është miratuar në muajin nëntor 2021[11], tre muaj pas miratimit të SSL dhe PV-së, ky aktivitet është konstatuar si i pazbatuar. Pasaktësi tjetër që vërehet ka të bëjë edhe me aktivitetin 19, fq. 43, i cili është konstatuar si pjesërisht e zbatuar, përkundër se sqarimi i dhënë tregon për përmbushje të plotë të këtij aktiviteti.

IKD, gjen edhe një rast tjetër të pasaktësisë për raportimin e aktiviteteve. Gjatë vitit 2022, është planifikuar miratimi i Rregullores për trajtimin e kërkesave dhe përzgjedhjen e lëndëve për ndihmë juridike falas. Aktiviteti është shënuar pjesërisht i zbatuar, me faktin se kjo rregullore pritet të hartohet pas miratimit të Ligjit të ri për Ndihmë Juridike Falas. Në ndërkohë, ky projektligj ishte i planifikuar të miratohej në vitin 2021, por që nuk ishte i përfshirë për miratim në programin legjislativ për vitin 2022, 2023 dhe as që është i planifikuar të miratohet për vitin 2024.

Një rast i mos identifikimit të saktë të institucioneve përgjegjëse për zbatimin e aktiviteteve është ai me numër 22, tek faqja 65, ku përgjegjës për përditësimin e portalit 'Gjykata ime' me informacione thelbësore shtesë dhe të thjeshtëzuara për publikun, përfshirë informacionin juridik, shabllonet e dokumenteve që duhet të dorëzohen në gjykatë dhe udhëzimet tjera për publikun është vendosur si institucion përgjegjës KGJK, përderisa këtë portal e ka krijuar dhe e mirëmban Fakulteti Juridik i Universitetit "Hasan Prishtina" të Prishtinës.[12]

Në një rast tjetër, IKD gjen se përkundër shënimit se Lista e avokatëve mbrojtës është e publikuar dhe kanë qasje secili në webfaqen e OAK-së, raportuesi atë e ka hijezuar me ngjyrën e kuqe si të pazbatuar, në ndërkohë nuk është dhënë arsye i duhur se cilat janë arsyet që është hijezuar me ngjyrën e kuqe apo është problem teknik. Aktivitet që mund të llogaritet i pasaktë për realizimin e tij, është edhe ai për miratimin e Strategjisë për Komunikim me Publikun në përputhje me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike, ku produkti në vitin 2022 do të ishte miratimi i strategjisë. Hartuesi i raportit, ka treguar që MD ka planifikuar grupin punues dhe pritet hartimi dhe miratimi i kësaj Strategjie gjatë vitit 2023.[13]

[11] "Rregullore për rekrutimin, provimin, emërimin dhe riemërimin e gjyqtarëve", Këshilli Gjyqësor i Kosovës, 2021. (Shih linkun: https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/lgs/66244_Rregullore_Nr_03_2021_per_rekrutimin_provimin_emerimin_dhe_riemerimin_gjyqtareve.pdf). (Qasur për herë të fundit 10 qershor 2024).

[12] "Raporti një vjeçar (2023) për zbatimin e Planit të Veprimit për zbatimin e SSL-it", fq.65. aktiviteti 22, Ministria e Drejtësisë. (Shih linkun: <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/7C77BBBD-C7BD-44D6-A5FC-AB21ADE19481.pdf>). (Qasur për herë të fundit 10 qershor 2024).

[13] Po aty, fq. 83, aktiviteti 2.

Pra, në kundërshtim me pritjet për produktin, në anën tjetër është planifikuar vetëm grupi punues dhe ky aktivitet cilësohet si pjesërisht i zbatuar. Pjesërisht, do të konsiderohej draftimi i strategjisë, vendosja e saj në Platformën Online të Konsultimeve Publike.

Ligji për Gjykatat në Republikën e Kosovës me dispozitat e tij parasheh që kryetarët e gjykatave themelore dhe Gjykata e Apelit janë përgjegjës për administrimin ditor të gjykatës në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara nga KGjK-ja.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës ushtron autoritet në lidhje me gjykatat nëpërmjet mekanizmave që rregullohen me dispozitat ligjore në fuqi, ku njëri prej tyre është nëpërmjet kryetarëve të gjykatave, të cilët duhet t'i raportojnë KGjK-së. Ligji për Gjykatat parasheh një mekanizëm zyrtar të raportimit të kryetarëve të gjykatave te KGjK-ja. Më konkretisht, me këtë ligj kërkohet nga kryetarët e gjykatave që të hartojnë, në bashkëpunim me gjyqtarët tjerë, Planin vjetor për menaxhimin e rasteve dhe t'i caktojnë rastet në departamente dhe gjyqtarë, dhe të raportojnë me shkrim në baza vjetore te KGjK-ja lidhur me suksesin e zbatimit të planit të tillë vjetor.

Të gjithë kryetarët e gjykatave e kanë obligim ligjor që të raportojnë në baza tremujore dhe vjetore tek KGjK-ja. Raportet vjetore të kryetarëve të gjykatave në fakt duhet të bazohen në informacionet e përfshira në raportet e rregullta tremujore. Të gjitha këto raporte (tremujore dhe vjetore) duhet të publikohen.

Instituti i Kosovës për Drejtësi gjithashtu ka trajtuar edhe më herët çështjen e "*Pavarësisë, Efikasitetit, Llogaridhënies dhe Integritetit të Sistemit Gjyqësor dhe Prokuroria*", ku mes tjerash ka trajtuar mangësitë përkitazi me problemet e raporteve tremujore^[14].

Në vitin 2023 në webfaqen zyrtare të Këshillit Gjyqësor të Kosovës vërejmë se këto raporte janë të publikuara, mirëpo sipas Raportit Vjetor për Zbatimin e Strategjisë për Sundimin e Ligjit të vitit 2023, thuhet se në përmbajtjen e këtyre raporteve tremujore gjatë vitit përfshihet edhe një pjesë e veçantë në të cilën raportohet për arsyet e shtyrjeve apo vonesave të seancave, ndonëse përmbajtja e raporteve tremujore përveç të dhënave statistikore të gjykatave, nuk ka të dhëna e aq më pak arsye lidhur me shtyrjen apo vonesën e seancave. IKD vlerëson se në këto raporte që publikohen në faqen zyrtare të KGjK-së, duhet të përfshihen statistikatat dhe arsyet specifike të shtyrjeve të seancave, përkundrazi kontribuohet në dëmtimin dhe mospërfilljen e efikasitetit, llogaridhënies dhe transparencës në gjyqësor.

Qeveria e Kosovës e ka bërë një hap të madh në fushën e SIL-it duke i krijuar profesionet e lira ligjore siç janë noterët, përmbaruesit privat, ndërmjetësuesit dhe administratorët e falimentimit, dhe duhet pranuar se janë bërë shumë përpjekje për t'i mbështetur dhe për t'i fuqizuar më tutje ato.

[14] Shala G. "*Pavarësia, Efikasiteti, Llogaridhënia dhe Integriteti i Sistemit Gjyqësor dhe Prokuroria*" Prishtinë, Instituti i Kosovës për Drejtësi, Janar, 2019. (Shih linkun: <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2023/10/Mos-Zbatimi-i-Strategjise-se-Sundimit-te-Ligjit-ne-Praktike-1.pdf>). (Qasur për herë të fundit më 10 qershor 2024).

Tani, ka ardhur koha që të mbështetet konsolidimi i dhe rritja e tyre institucionale në mënyrë që ato të bëhen partnerë të besuar të sistemeve juridike, në cilësinë e shërbimeve të cilave ato duhet të kontribuojnë me të vërtetë. Ka nevojë për ndërmarrjen e masave të mëtutjeshme në linjë me standardet evropiane dhe ndërkombëtare dhe me praktikat më të mira.

Sipas dokumentit të politikave, Përmirësimi i cilësisë së ofrimit të shërbimeve në profesionet e ndërlidhura me sistemin e drejtësisë, sa i përket përmbartimit thuhet nevojitet një numër i veprimeve dhe ato kanë të bëjnë me sigurimin e shpërndarjes së barabartë gjeografike të shërbimeve të përmbartimit privat përmes rekrutimit shtesë të agjentëve përmbartues privatë. Ky dokument kur i referohet rekrutimit, shprehimisht nënkupton rritjen e numrit të përmbartuesve.

Qëllimi mbi përmirësimin e ofrimit të shërbimeve nga profesionet e lira ligjore (PLL), sipas Strategjisë për Sundimin e Ligjit synon fuqizimin e mëtutjeshëm të roleve dhe kompetencave përkatëse të PLL-ve duke pasur për qëllim ngritjen e cilësisë së shërbimeve të ofruara nga PLL-të. Duke u thirrur në përmirësimin e ofrimit të shërbimeve të lira, njëra nga masat që del nga SSL, parashihet të jetë edhe shtimi i numrit të përmbartuesve privat për një shpërndarje më të mirë gjeografike, dhe krijimi i një sistemi uniform për mbledhjen e të dhënave, për të pasur një pasqyrë më të mirë të performancës së sistemit.

Ndërsa, sipas Raportit Vjetor për Zbatimin e Strategjisë për Sundimin e Ligjit të vitit 2023, marrja e vendimit për rekrutimin e 10 përmbartuesve privat shtesë apo të rinj, me qëllim të një shpërndarje më të mirë gjeografike të shërbimeve të përmbartimit, konsiderohet si aktivitet gjysmë i përfunduar. Realisht në tetor të vitit 2023, është hapur vetëm një konkurs nga Ministria e Drejtësisë, i cili konkurs i referohet emërimit të përmbartuesve privat dhe jo rekrutimit të përmbartuesve privat shtesë, siç është cekur në raportin vjetor. Gjithashtu në këtë raport thuhet se në vitin 2023 planifikohet shpallje e re për emërim, që nënkupton se vet raporti bën dallimin mes rekrutimit dhe emërimit, ku me rekrutim i referohet konkursit përmes së cilit kandidatët që aplikojnë, mund të fitojnë statusin e përmbartuesit privat (duke ju nënshtruar testimit dhe procedurave të tjera të rregulluara me ligj) dhe me emërim i referohet konkursit përmes së cilit përmbartuesit që tashmë janë të zgjedhur dhe kanë kaluar testimin dhe procedurat e tjera të rregulluara me ligj dhe aplikojnë për emërim nëpër territore të caktuara të Republikës së Kosovës. Andaj, lidhur me këtë çështje IKD ka gjetur se Raporti mbi zbatimin e SSL-së, ka dështuar ta definojë saktësisht këtë çështje.

Ligji për Ndërmjetësimin parasheh që Ministria e Drejtësisë mbetet kompetente për të elaboruar politikat zhvillimore për profesionin e ndërmjetësimit, trajnimit, certifikimit dhe mbikëqyrjes së ndërmjetësuesve. Sipas Dokumentit të politikave lidhur me përmirësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të profesioneve të lira, fuqizimi i mëtejshëm i kapaciteteve të MD-së në lidhje me këtë çështje nevojitet për të qenë në gjendje për t'i ushtruar kompetencat e tilla. Deri tani, trajnimi i ndërmjetësuesve është financuar kryesisht nga donatorë të ndryshëm dhe projekte në baza ad hoc.

Specializimi i ndërmjetësuesve (posaçërisht në fushën e ndërmjetësimit në familje, e cila është më e ndjeshmja) është një pikë e dobët në sistemin trajnues të ndërmjetësuesve në Kosovë[15], dhe nuk ka ndonjë kurrikulë trajnuese fillestare për ndërmjetësuesit[16]. Më tej, rekomandimet që tashmë iu janë dhënë autoriteteve relevante të Kosovës parashohin që ndërmjetësuesit duhet të vijnë rregullisht kurse rifreskuese.

Sipas Strategjisë për Sundimin e Ligjit, janë paraparë një varg aktivitete që kanë për qëllim ngritjen e cilësisë së shërbimeve të të gjitha PLL-ve. Kjo do të arrihet përmes hartimit/përmirësimit të kurrikulave trajnuese fillestare, të vazhdueshme dhe të specializuara për të gjitha PLL-të mbi bazën e analizave gjithëpërfshirëse të nevojave përkatëse të trajnimit. Përmes hartimit të një kurrikule të tillë do të arrihet edhe lehtësimi i ngarkesës së punës në gjykata dhe prokurori, si dhe garantimi i ekzistimit të sundimit të ligjit që siguron të drejtën për gjykim dhe shqyrtim të drejtë në një afat të arsyeshëm kohor për qytetarët/et.

Përmes hartimit të një kurrikule të tillë do të arrihet edhe lehtësimi i ngarkesës së punës në gjykata dhe prokurori, si dhe garantimi i ekzistimit të sundimit të ligjit që siguron të drejtën për gjykim dhe shqyrtim të drejtë në një afat të arsyeshëm kohor për qytetarët/et.

Në Raportin vjetor mbi zbatimin e Strategjisë për Sundimin e Ligjit, lidhur me hartimin e kësaj kurrikule aq të rëndësishme, tregohet se afati i fundit për tu hartuar ka qenë në vitin 2021, ndërsa ende nuk është hartuar por është identifikuar si aktivitet gjysmë i zbatuar, pasi që drafti i kurrikulave ka kaluar fazën e konsultimeve dhe ndodhet në Departamentin Ligjor të Ministrisë së Drejtësisë. IKD, lidhur me këtë çështje vlerëson se hartimi i dokumenteve të tilla aq të rëndësishme që ndikojnë në lehtësimin e ngarkesës së punës në gjykata dhe prokurori dhe jo vetëm, duhet të konsiderohet me prioritet dhe seriozitet.

8. Stagnimi në “proces”

Evidentimi i aktiviteteve të caktuara si pjesërisht të zbatuara supozon fillimin e procesit të zbatimit të aktiviteteve të caktuara, i cili proces duhet të përfundojë brenda një afati të arsyeshëm. Kjo nuk ka ndodhur kështu në raport me shumë aktivitete të përcaktuara në PV të SSL-së. Stagnimi i institucioneve në realizimin e obligimeve për përmbushjen e aktiviteteve të përcaktuara në Planin e Veprimit të SSL-së edhe pas afër tri viteve të miratimit të PV të SSL-së është karakteristikë e zbatimit të këtij Plani. Kjo pasi shumë aktivitete në vitin 2022 u evidentuan si pjesërisht të zbatuara, por që zbatimi i tyre nuk përfundojë as në vitin 2023.

Në këtë drejtim, IKD ka evidentuar gjithsej 71 aktivitete të vitin 2022, të cilat në Raportin vjetor për zbatimin e Strategjisë për Sundimin e Ligjit 2023, janë evidentuar si pjesërisht të zbatuara, por që zbatimi i tyre nuk ka përfunduar as në vitin 2023.

[15] “Projekti i financuar nga BE-ja “Mbështetje për Profesionet e Lira Ligjore dhe Odën e Avokatëve” (EuropeAid/136612/DH/SER/XK) - Projekt Rekomandimet për Ndërmjetësuesit/ Raport Paraprak mbi Sfidat për Profesionet e Lira Ligjore, qershor 2017

[16] Po aty.

Situata e fillimit të zbatimit të aktiviteteve që janë të parapara për një vit të caktuar dhe mos përfundimi i zbatimit të atyre aktiviteteve as në vitin pasues paraqet një mos angazhim adekuat të institucioneve në zbatimin e SSL-së.

Në anën tjetër, IKD ka evidentuar gjithsej 38 aktivitete të vitit 2022, të cilat në bazë të Raportit vjetor për zbatimin e Strategjisë për Sundimin e Ligjit 2023. është dashur të përfundojnë në vitin 2022. Por, këto aktivitete, nuk janë përmbushur fare, madje as nuk kanë filluar të përmbushen, as në vitin 2023.[17]

Kështu, kjo gjendje dëshmon se në një pjesë të caktuar të PV-së të SSL-së, institucionet kanë stagnuar, duke mos avancuar tutje në zbatimin e të njëjtave.

Stagnim siç shihet është edhe njëra prej reformave kryesore, pjesë e PV-së të SSL-së 2021-2023, është reforma në Këshillin Prokurorial të Kosovës. Kur ka përfunduar afati i PV-së të SSL-së dhe Qeveria është pothuajse në fund të mandatit të saj, reforma në KPK nuk është jetësuar. Kjo përkundër faktin se në PV të SSL kjo reformë duhej të përfundohej në vitin 2023.

KONKLUZION

Këto 71 aktivitete të evidentuan si pjesërisht të zbatuara që nga vitit 2022, të njëjtat nuk u zbatuan as në vitin 2023. Ndërsa, 38 aktivitete që duhej të përfundonin në vitin 2022, nuk filluan të përmbushen as në vitin 2023. Kjo situatë paraqet mos angazhim adekuat të institucioneve në zbatimin e SSL.

9. Mungesa e barazisë gjinore në KPK

Strategjia për Sundimin e Ligjit është përkujdesur që përmes aktiviteteve të veta të sigurohet që institucionet e sundimit të ligjit janë duke e respektuar barazinë gjinore. Kësaj i kanë paraprirë dokumentet e politikave për Rishikimin Funkcional të Sundimit të Ligjit në Kosovë, të cilat në frymën e parimeve të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit për Barazi Gjinore dhe akteve tjera ligjore dhe nënligjore të vetë institucioneve të sistemit të drejtësisë, të caktojë obligime të cilat do të ndikojnë që Këshilli Gjyqësor dhe ai Prokurorial si dy institucionet kryesore politikbërëse të sistemit të drejtësisë të respektojnë barazinë gjinore. Në dokumentin e politikave për Rishikimin Funkcional të Sundimit të Ligjit në Kosovë "Përmirësimi i integriteti të gjyqtarëve dhe prokurorëve", kur flet për përbërjen e KPK-së, konstaton që korniza ligjore është në pajtim me standardet ndërkombëtare pasi që krijon një KPK të pavarur nga institucionet tjera shtetërore, pasqyron natyrën multi-etnike të Kosovës, e njeh nevojën për barazi gjinore.....[18]

[17] "Raporti një vjeçar (2023) për zbatimin e Planit të Veprimit për zbatimin e SSL-it", fq.19-99. Ministria e Drejtësisë. (Shih linkun: <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/7C77BBBD-C7BD-44D6-A5FC-AB21ADE19481.pdf>). (Qasur për herë të fundit 10 qershor 2024).

[18] "Përmirësimi i integriteti të gjyqtarëve dhe prokurorëve". Dokumenti i Politikave, fq. 74, Ministria e Drejtësisë. 2019

PV i SSL-së ka paraparë që KGJK dhe KPK duhet të zbatojnë politika të cilat sigurojnë përfaqësim gjinor dhe etnik. Përkundër kësaj, KPK aktualisht është duke funksionuar pa përfaqësim adekuat gjinor nga 27 marsi 2024, kur edhe i ka kaluar mandati prokurores Merita Bina-Rugova si anëtare e KPK-së nga radhët e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK). Nga 12 anëtar që ka aktualisht KPK, vetë dy janë gra, ndërsa Rregullorja Nr.06/2020 për Zgjedhjen e Anëtarëve Prokurorë të Këshillit Prokurorial të Kosovës, konkretisht Neni 5, paragrafi 2, ka paraparë që KPK duhet të kujdeset dhe të bëjë vlerësimet paraprake mbi nivelin e përfaqësimit gjinor. Ndërsa paragrafi 3 i po nenit 5 ka paraparë që KPK-ja do të angazhohet të sigurojë që në përbërjen e saj të ketë së paku një (1) anëtar nga komunitetet joshumicë dhe së paku tre (3) anëtarë të gjinisë femërore” [19].

KPK ka pasur mundësi për të mos e bërë këtë shkelje duke zgjedhur një grua (prokurore) për të pasuar vendin e liruar nga tashme ish anëtarja e KPK-së, Merita Bina-Rugova. KPK ka bërë të kundërtën ku në mesin e dy kandidatëve për anëtar të vetë nga radhët e PSRK-së, prokurores Habibe Salihu dhe prokurorit Milot Krasniqi, ka zgjedhur këtë të fundit. Pa marrë parasysh se në zgjedhjet e mbajtura më 15 mars 2024, për anëtarin e KPK-së nga radhe e PSRK-së, prokurori Krasniqi ka arritur të marrë 10 vota, ndërsa prokurorja Salihu tri vota, në këtë rast në bazë të akteve ligjore por edhe të praktikave të mëhershme të vetat, KPK është dashur që të veprojë në atë drejtim për të plotësuar përfaqësimin gjinor në përbërjen e saj. KPK në të kaluarën ka pasur situata të tilla të ngjashme, e ku veprimi në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kujtojmë se në zgjedhjet e zhvilluara në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë, në tetor të vitit 2020 në votimin e dytë në garë kishin qenë prokurorët Jovo Radoviq dhe Naim Beka. Prokurori Beka e kishte fituar besimin e prokurorëve me 11 vota, ndërsa prokurori Radoviq kishte marrë vetëm 9 vota. Megjithatë, edhe pse humbës i zgjedhjeve, prokurori Radoviq ishte zgjedhur anëtar i KPK-së, kjo për faktin e arritjes së qëllimit të përfaqësimit etnik në KPK, pasi prokurori Radoviq vinte nga komuniteti serb.[20]

Që të mos bëjë një shkelje të tillë, KPK përmes një komunikate për media ishte paralajmëruar edhe nga tri Organizata të shoqërisë civile. IKD, Lëvizja FOL dhe INPO përmes një komunikate për media më 18 mars 2024 i bënë thirrje KPK që në përputhje me kompetencat që ka, të garantojë përfaqësimin gjinor në përbërjen e vet me rastin e votimit për anëtarin e ri të Këshillit nga radhët e prokurorëve të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës.[21].

Lidhur me kërkesën e OJQ-ve, ishte diskutuar në takimin e 244-të të KPK-së të mbajtur më 19 mars 2024. Po ashtu, gjatë këtij takimi, dyshimet për shkelje të akteve ligjore dhe nënligjore që rregullojnë kuotën gjinore të përbërjes së KPK-së kishin shprehur edhe një pjesë e anëtarëve të KPK-së.[22]

[19] “Rregullorja Nr.06/2020 për Zgjedhjen e Anëtarëve Prokurorë të Këshillit Prokurorial të Kosovës”, Neni 5, paragrafi 2 dhe 3.

[20] “Edhe pse humbës i zgjedhjeve, prokurori Jovo Radoviq zgjidhet anëtar i ri i KPK-së,” Betimi për Drejtësi. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/edhe-pse-humbes-i-zgjedhjeve-prokurori-jovo-radoviq-zgjidhet-anetar-i-ri-i-kpk-se/>). (Qasur për herë të fundit 10 qershor 2024).

[21] “IKD, FOL dhe INPO: KPK-ja të sigurojë përfaqësim gjinor me së paku tri anëtare gra, me zgjedhjen e anëtarit të ri nga radhët e PSRK-së, Betimi për Drejtësi. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/ikd-fol-dhe-inpo-kpk-ja-te-siguroje-perfaqesim-gjinor-me-se-paku-tri-anetare-gra-me-zgjedhjen-e-anetarit-te-ri-nga-radhet-e-psrk-se/>). (Qasur për herë të fundit 10 qershor 2024).

[22] “Takimi i 244-të i KPK-së i mbajtur më 19 mars 2024, dhe i transmetuar drejtpërdrejt përmes faqes se Facebook-ut të sistemit prokurorial”. (<https://www.facebook.com/61551128751137/videos/446639384457586>)

Lidhur me plotësimin e kuotës gjinorë në përbërjen e KPK-së Kryesuesi Ardian Hajdaraj në takimin e 244-të kishte deklaruar se i kanë edhe dy vende të pa plotësuar, një anëtar nga radhët e Prokurorisë Themelore të Mitrovicës dhe një anëtar joprokuror nga radhët e Odes së Avokatëve të Kosovës. Madje ai në një moment tha se do bëjmë kërkesë zyrtare drejtuar Odes së Avokatëve të Kosovës që ta propozojë një grua[23], duke harruar se Rregullorja Nr.06/2020 për Zgjedhjen e Anëtarëve Prokurorë të Këshillit Prokurorial të Kosovës, konkretisht Neni 5, paragrafi 3, thotë se KPK-ja do të angazhohet të sigurojë që në përbërjen e saj të ketë së paku tre (3) anëtarë të gjinisë femërore, e jo që një angazhim të tillë ta bëjë Oda e Avokatëve të Kosovës. Kështu, KPK nuk ka mundësi që obligimet e saja t'i bartë tek një institucion tjetër.

Oda e Avokatëve të Kosovës ka dërguar propozimet e saj për anëtarë të KPK, ku nga tre propozimet, asnjë nuk ishte grua[24]. Më 16 maj 2024, Kuvendi zgjodhi një burrë anëtarë të KPK-së nga radhët e OAK-ut.

Ndërsa, arsytimi që kuota gjinore do të plotësohet me anëtarin e KPK-së që do të zgjidhet nga radhët e Prokurorisë Themelore të Mitrovicës, nuk e amnistojnë KPK-në që të funksionojë për një periudhë pa afat duke shkelur të drejtat për barazi gjinore, kur dihet që anëtari që duhet të zgjidhet nga radhët e Prokurorisë Themelore të Mitrovicës duhet të plotësojë jo vetëm kuotën gjinore, por edhe atë etnike, pasi në përbërjen e vetë duhet të ketë se paku edhe një anëtarë nga komunitetet joshumicë. Plotësimi i këtyre dy kuotave është vështirë i parashikueshëm duke ditur që të gjithë prokurorët serbë nga radhët e kësaj prokurorie kishin ofruar dorëheqje dhe nuk e ushtrojnë profesionin e tyre që nga 7 nëntori 2022 [25], ndërsa ende nuk dihet si do të veprohet tutje me zëvendësimin e tyre. Sipas qëndrimit të KPK, deri në atë ditë, KPK do të funksionojë pa përfaqësim adekuat gjinor.

KONKLUZION

Mungesë e vullnetit të KPK-së për të respektim të barazisë gjinore, dhe si pasoje e këtij vullneti të munguar një institucion kushtetues siç është KPK, është duke funksionuar me përbërje në kundërshtim të plotë me aktet ligjore dhe nënligjore të vet-hartuara, por edhe në kundërshtim me zotimin e vet për reformim të sistemit të drejtësisë.

[23] "Takimi i 244-të i KPK-së i mbajtur më 19 mars 2024, dhe i transmetuar drejtpërdrejt përmes faqes se Facebook-ut të sistemit prokurorial". (<https://www.facebook.com/61551128751137/videos/446639384457586>)

[24] "Ekskluzive: Këta janë kandidatët e propozuar nga Oda e Avokatëve për pozitën e një anëtari në KPK (Emrat)", Betimi për Drejtësi. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/ekskluzive-keta-jane-kandidatet-e-propozu-ar-nga-oda-e-avokateve-per-poziten-e-nje-anetari-ne-kpk-emrat/>). (Qasur për herë të fundit 10 qershor 2024).

[25] "Ofrojnë dorëheqje 10 prokurorë të komunitetit serb të Prokurorisë Themelore të Mitrovicës", Betimi për Drejtësi. (Shih linkun: <https://prokuroria-rks.org/kpk/lajm/ofrojne-doreheqje-10-prokurore-te-komunitetit-serb-te-prokurorise-themelore-te-mitrovices/>). (Qasur për herë të fundit 10 qershor 2024).

10. Mos zbatimi i aktiviteteve lehtë të zbatueshme

Në Raportin Vjetor për Zbatimin e SSL-së, për disa nga aktivitet të cilat janë konsideruar të pjesërisht të përmbushura, përmbajnë aktivitete të tjera për të cilat institucionet lehtësisht dhe pa ndonjë pengesë të theksuar do të mund t'i zbatonin. Në kuadër të disa aktiviteteve të KGJK-së, janë planifikuar fushata mediale me qëllim të ndërgjegjësimit të publikut për sistemin e ri ligjor të përgjegjësive disiplinore të gjyqtarëve, por kjo nuk është realizuar plotësisht, derisa KGJK ka vendosur postere informativë në të gjitha gjykatat dhe degët e tyre. Lancimi i fushatave mediale, nuk do të duhej të ishte aktivitet i komplikuar për t'u realizuar. Shtuar kësaj mbështetjen e vazhdueshme që KGJK gëzon nga donatorët.

Të njëjtin aktivitet nuk e ka përmbushur as KPK gjatë vitit 2023[26], siç është elaboruar në kapitullin e "Pasaktësisë". Kjo përkundër faktin se sikurse në rastin e KGJK, zbatimi i këtij aktiviteti nuk përmban ndonjë vështirësi të theksuar.

Aktiviteti tjetër, lehtë i zbatueshëm në kuptimin operacional është edhe zhvillimi i anketave të rregullta publike me publikun, bizneset dhe profesionistët, i cili është planifikuar të zbatohet nga KGJK, KPK dhe MD. Shënimi zyrtar tregon që për këtë aktivitet nuk ka pasur zhvillime dhe asnjë arsytim për shkaqet e mos-kryerjes së këtij aktiviteti.[27]

Hartimi i udhëzimeve për prokuroritë lidhur me rrjetet sociale, është aktiviteti tjetër që fillimisht është dukur i "zorshëm" për t'u zbatuar. Vetëm pas dy viteve, Raporti tregon se draftimi i këtij Udhëzuesi është siguruar nga donatorët[28].

Dokumenti i Politikave lidhur me Rolin dhe Strukturën e Ministrisë së Drejtësisë, parasheh se në disa departamente, ka shumë pak punonjës që flasin gjuhë të huaja.[29] Sipas këtij dokumenti gjuha angleze duhet të jetë një parakusht për të punuar në MD dhe veçanërisht në departamentet si ai për Integritet Evropian, Departamenti Ligjor dhe Departamenti për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar. Andaj, rekrutimi i katër zyrtarëve të rinj me njohuri të avancuara të gjuhës angleze në Departamentin për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave, edhe pse është dashur të përfundonte në vitin 2022 nga Ministria e Drejtësisë, i njëjti aktivitet ka dështuar që ta implementoj këtë pikë edhe në vitin 2023 edhe pse zbatimi i tillë nuk paraqet pengesa të konsiderueshme.

[26] "Raporti një vjeçar (2023) për zbatimin e Planit të Veprimit për zbatimin e SSL-it", fq.25, aktiviteti 40, Ministria e Drejtësisë. (Shih linkun: <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/7C77BBBD-C7BD-44D6-A5FC-AB21ADE19481.pdf>). (Qasur për herë të fundit 10 qershor 2024).

[27] "Raporti një vjeçar (2023) për zbatimin e Planit të Veprimit për zbatimin e SSL-it", fq.29, aktiviteti 56, Ministria e Drejtësisë. (Shih linkun: <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/7C77BBBD-C7BD-44D6-A5FC-AB21ADE19481.pdf>). (Qasur për herë të fundit 10 qershor 2024).

[28] "Plani i Veprimit (2021-2023) për zbatimin e Strategjisë për Sundimin e Ligjit 2021-2026", Gusht 2021 dhe Raporti një vjeçar (2022) për zbatimin e Planit të Veprimit për zbatimin e SSL-it, fq.29, aktiviteti 57, Zyra e Kryeministrit, Mars 2023. (Shih linkun: <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/04/Raporti-1-vjecar-FINAL.pdf>). (Qasur për herë të fundit 10 qershor 2024).

[29] "Raporti një vjeçar (2023) për zbatimin e Planit të Veprimit për zbatimin e SSL-it", fq.87, aktiviteti 8, Ministria e Drejtësisë. (Shih linkun: <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/7C77BBBD-C7BD-44D6-A5FC-AB21ADE19481.pdf>). (Qasur për herë të fundit 10 qershor 2024).

KONKLUZION

Rekrutimi i zyrtarëve të rinj me njohuri të avancuara të gjuhës angleze është paraparë edhe në Departamentin Ligjor të MD-së, ku në raportin e zbatimit të Strategjisë për Sundimin e Ligjit përmendet një zyrtar me njohuri të avancuara të gjuhës angleze[30], i cili ishte transferuar nga Zyra e Kryeministrit e më pas ka dhënë dorëheqje dhe ky aktivitet konsiderohet si gjysmë i përfunduar, përderisa zyrtari nuk është rekrutuar, ashtu siç kërkohet. Konkluzion: PV-ja e SSL-së përmban aktivitete të rëndësishme por të cilat janë lehtë të zbatueshme. Mos angazhimi i institucioneve për të zbatuar aktivitetet e parapara, zbatimi i të cilave nuk ka pengesa të theksuara, paraqet mundësi të vullnetit të institucioneve për zbatimin e SSL.

11. Koncept Dokumenti për Persona që u është kufizuar liria e lëvizjes nga Gjykata

Plani i Veprimit (2021-2023) për zbatimin e Strategjisë për Sundimin e Ligjit 2021-2026, tek Masa e politikës: Zhvillimi i legjislacionit, kishte paraparë hartimin e Koncept Dokumentit për mbikëqyrjen elektronike të personave të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim të gjykatës, për të analizuar përfshirjen e monitorimit elektronik.[31] Një dokument i tillë nuk ishte miratuar edhe pse ishte planifikuar të miratohej gjatë vitit 2022. Në Raportin njëvjeçar (2022) për zbatimin e PV-së të SSL-së, ky aktivitet është thënë se është zbatuar pjesërisht[32] me faktin se një koncept dokument i tillë është përfshirë në kuadër të Planit Kombëtar për Zhvillim për vitin 2023.[33]

Raporti për zbatimin e PV-së të SSL-së për vitin 2023 thekson se më ky aktivitet nuk është i nevojshëm. Përkundër kësaj, këtë aktivitet e konsideron si pjesërisht të zbatuar. Komentet e Ministrisë së Drejtësisë tek ky veprim, tregojnë se "Meqë janë ndarë fonde për zbatimin e Ligjit për mbikëqyrjen elektronike të personave të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim të gjykatës, atëherë Ministria e Drejtësisë e ka pezulluar hartimin e këtij Koncept Dokumenti. Bazuar në studimin e fizibilitetit për monitorim elektronik është bërë kostimi dhe tashmë ka hyrë në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve për tri (3) vite ". Për këtë arsye, MD propozoi që ky aktivitet të largohet gjatë rishikimit të Strategjisë për Sundim të Ligjit/Planit të Veprimit. [34]

Përkitazi me këtë aktivitet, janë dy probleme: Planifikimi jo adekuat i aktivitetit dhe pasaktësia në raportim.

[30] "Raporti një vjeçar (2023) për zbatimin e Planit të Veprimit për zbatimin e SSL-it", fq.87, aktiviteti 8, Ministria e Drejtësisë. (Shih linkun: <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/7C77BBBD-C7BD-44D6-A5FC-AB21ADE19481.pdf>). (Qasur për herë të fundit 10 qershor 2024).

[31] "Plani i Veprimit (2021-2023) për zbatimin e Strategjisë për Sundimin e Ligjit 2021-2026", Gusht 2021 dhe Raporti një vjeçar (2022) për zbatimin e Planit të Veprimit për zbatimin e SSL-it, fq.50, Zyra e Kryeministrit, Mars 2023. (Shih linkun: <https://kryeministri.rks-gov.net/ep-content/uploads/2023/04/Raporti-1-vjecar-FINAL.pdf>). (Qasur për herë të fundit 10 qershor 2024).

[32] "Raporti një vjeçar (2022) për zbatimin e Planit të Veprimit për zbatimin e SSL-it", fq.50, Zyra e Kryeministrit. (Shih linkun: <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/04/Raporti-1-vjecar-FINAL.pdf>). (Qasur për herë të fundit 10 qershor 2024).

[33] "Plani-Kombetar-per-Zhvillim-2023-2025", fq. 65, 15 mars 2023, Zyra e Kryeministrit. (Shih linkun: <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/03/06032023-RKS-Plani-Kombetar-per-Zhvillim-2023-2025.pdf>). (Qasur për herë të fundit 10 qershor 2024).

[34] "Raporti një vjeçar (2023) për zbatimin e Planit të Veprimit për zbatimin e SSL-it", fq.55, Ministria e Drejtësisë. (Shih linkun: <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/7C77BBBD-C7BD-44D6-A5FC-AB21ADE19481.pdf>). (Qasur për herë të fundit 10 qershor 2024).

Ministria e Drejtësisë, ishte në dijeni të një raporti për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Mbikëqyrjen Elektronike të Personave që u kufizohet lëvizja me vendim të Gjykatës, një raport që ishte realizuar në vitin 2022 nga Komisioni për Legjislacion, e ku pjesëmarrës në përgjigje ishin edhe zyrtarë të Ministrisë së Drejtësisë. Raporti konstatonte se ligji është i pazbatueshëm në praktikë, jo për shkak të nevojës për ndryshime ligjore, por për mosveprim të institucioneve përgjegjëse, si Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Punëve të Brendshme.[35] Përkundër kësaj, hartimi i një Koncept Dokumenti u përfshi në PV të SSL-së. Për më tepër, ky Koncept Dokumenti u konstatua pjesërisht i zbatuar në Raportin vjetor të zbatimit të SSL-së për vitin 2022. Ndërsa, në Raportin për zbatimin e SSL-së për vitin 2023, ky aktivitet propozohet të hiqet. Kjo situatë, tregon një planifikim jo adekuat të MD-së dhe MPB-së, të cilave iu është dashur vite të tëra për të kuptuar mungesën e nevojës të këtij Koncept Dokumenti, përkundër që Raporti i Komisionit për Legjislacion ekzistonte edhe para miratimit të PV-së të SSL-së.

Në anën tjetër, është paradoksale se si një aktivitet që tanimë konsiderohet i panevojshëm dhe propozohet të fshihet, evidentohet si aktivitet pjesërisht i zbatuar dhe kjo më pastaj reflektohet edhe në përqindjen e përgjithshme të zbatimit të PV-së të SSL-së.

KONKLuzion

Krahas mungesës së përkushtimit të institucioneve në procesin e identifikimit të problemeve me zbatimin e Ligjit për Mbikëqyrjen Elektronike për Personat të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim të Gjykatës, gjënë edhe planifikim jo adekuat të MD-së dhe MPB-së në këtë fushë. Përkundër ekzistimit të një raporti të Komisionit për Legjislacion që qartësonte problemet në këtë fushë, PV dhe SSL planifikoj hartimin e një Koncept Dokumenti, që vetëm rreth 2 vite pas, u konstatua se është i panevojshëm. Krahas kësaj, IKD gjënë se situata si kjo kur aktivitetet që propozohen të fshihen evidentohen si pjesërisht të zbatuara paraqesin raportim të pasaktë lidhur me zbatimin e PV të SSL.

[35] "Nuk gjen zbatim Ligji për Mbikëqyrjen Elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim të gjykatës", Betimi për Drejtësi. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/nuk-gjen-zbatim-ligji-per-mbikëqyrjen-elektronike-te-personave-te-cileve-u-kufizohet-levizja-me-vendim-te-gjykatës/>). (Qasur për herë të fundit 10 qershor 2024).

Raporti "**Strategjia në udhëkryq**" është realizuar nga Instituti i Kosovës për Drejtësi me mbështetjen e National Endowment for Democracy (NED).



Instituti i Kosovës për Drejtësi
Kosovo Law Institute
Kosovski Institut Pravde

